

UDHËZIM
Nr.9, datë 22.8.2006

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT”

Në mbështetje të nenit 102 pika e 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në fund të pikës 2.12 të udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, me ndryshime, shtohet paragrafi 2.13 si vijon:

2.13. Importuesit e rrushit për përpunim industrial, që nuk janë të autorizuar si tatimpagues akcize subjekte të prodhimit të verës dhe pijeve alkoolike, do të paraqesin në degën e doganës ku do të kryejnë zhdoganimin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Certifikatën e regjistrimit të personit të tatueshën (NIPTI-n).

b) Autorizimin e lëshuar nga tatimpaguesi i autorizuar i akcizës për prodhimin e verës dhe pijeve alkoolike, i cili vërteton se sasia e rrushit të importuar është për llogari të tij, së bashku me kopjen e certifikatës të regjistrimit të personit të tatueshëm (NIPTI-n) të tatimpaguesit të autorizuar të akcizës për prodhimin e verës dhe pijeve alkoolike.

Degët e doganave nuk do të lejojnë zhdoganimin e sasisë së rrushit për përpunimin industrial, kur subjekti që importon nuk paraqet (një kopje e dokumenteve të mësipërme do të bashkëngjiten në praktikën doganore) dokumentacionin e sipërpërmendur.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode